



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 235 prot. i AK, datë 13.04.2023 “Njoftim Përqendrimi” me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përftrimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

Referuar “Marrëveshje Kuadër Investimi e propozuar”, palët në transaksion janë:

Blerësi 1: Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A., një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian me objekt aktiviteti menaxhimi i entiteteve të investimit kolektiv të kursimeve alternative dhe rreziqet përkatëse si dhe administrimit dhe tregtimi i tyre; ofrimi i shërbimeve të Menaxhimit të Portofoleve; ofrimi i shërbimeve ndihmëse si dhe kryerja e veprimtarive përkatëse dhe instrumentale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi etj. Eurizon Capital Real Asset SGR S.p.A. është një shoqëri që i përket Grupit Intesa Sanpaolo, i cili është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Blerësi 2: Sarafin S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Italian, shoqëri holding, të ardhurat e të cilës i atribuohen linjave të mëposhtme të biznesit: 1. Menaxhimi i shtëpive të kujdesit për të moshuarit; 2. Ndërtimi (Tenderat); 3. Pasuri të Paluajtshme (qira dhe shitje); 4. Ushqim & Pije; 5. Shërbime të caktuara ndihmëse si kontabiliteti dhe listë-pagesat, rikuperimi i kredive dhe arkivimi i dokumenteve.

Sarafin S.p.A. nuk ka filiale dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Shitësi 1: Mittel S.p.A. është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian. dhe

Shitësi 2: Blustone S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian.

Shoqëria Target: Gruppo Zaffiro S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Italian, një shoqëri holding, shoqëria mëmë e një grupi shoqëriash aktive në sektorin e menaxhimit operacional dhe zhvillimit të pasurive të paluajtshme të objekteve të mirëpritjes dhe / ose të kujdesit shëndetësor dhe / ose të mirëqenies sociale, të tilla si shtëpitë e strehuara dhe shtëpitë e pushimit për të moshuarit.

Gruppo Zaffiro S.r.l. nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.